

Gjikhuri Damian
Minister



Z. Damian Gjikhuri lindi më 25 Maj 1972, në qytetin e Tiranës. Ai banon në Tiranë dhe është i martuar me Rovena Gjikhurin (Agollin), me të cilën ka një djalë, Aleksin dhe një vajzë, Katerinën.

Ai është i diplomuar në Drejtësi në vitin 1994, në Universitetin e Tiranës dhe zotëron gradën Master në Politikat Publike dhe Ligj të lëshuar nga "NPS School" të Monterey, Kaliforni, SHBA (2004) dhe Kolegji i Ligjit Londër, Britani e Madhe (1996). Ai ka kryer edhe disa studime pasuniversitare në Qendrën për Politikat e Sigurisë në Gjenevë (2000) dhe të Drejtë Ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit, Holandë (1994). Gjatë aktivitetit profesional ka kryer dhe kurse të ndryshme profesionale në institucione të ndryshme arsimore dhe profesionale në SHBA dhe BE, në fushat e sigurisë, mjetet speciale të hetimit, hetimi penal, kontratat publike, koncesionet, politika publike, ligjet zgjedhore etj.

Z. Gjikhuri është anëtar i Partisë Socialiste që nga viti 2005 dhe është zgjedhur Deputet në Qarkun e Elbasanit (Gramsh) në vitin 2009 dhe 2013. Ai është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste dhe që nga viti 2011 deri në vitin 2016 ka qenë Sekretar për Çështjet Zgjedhore. Më parë, në vitin 2007 ai u zgjodh Nënkryetar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore dhe bashkëautor i Kodit Zgjedhor 2008.

Gjikhuri ka qenë anëtar i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë (2009 - 2013), si dhe bashkëkryetar i Komisionit të Reformës Zgjedhore 2011 - 2012.

Përpara zgjedhjes si deputet në vitin 2009, Z. Gjikhuri ka punuar si drejtues i një zyre ligjore dhe këshilltar ligjor për reformat rregullatore ekonomike në vend dhe rajon, financuar nga BE, USAID, GTZ, etj. Deri në vitin 2005, Z.

Gjikhuri ka ushtruar funksione të ndryshme publike si: Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Rendit Publik (2005), Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes (2001 - 2005), Drejtor i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Rendit Publik dhe koordinator kombëtar për çështjet e drejtësisë dhe ato të brendshme, për negociimin e hapjes së negociatave me KE (1999 - 2001), Drejtues i Planizim - Drejtimit në SHISH (1998), Gjyqtar i Shkallës së Parë (1995-1996), jurist në institucione të ndryshme (1994-1995).

Ai zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe mirë gjuhën italiane.